

## Zhvillohet në Universitetin e Elbasanit ligjeratë me titull "Hebrenjtë dhe shpëtimi i tyre nga shqiptarët"

Në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", është zhvilluar një ligjeratë me titull "Hebrenjtë dhe shpëtimi i tyre nga shqiptarët", nga profesori i historisë së letërsisë hebreje në Universitetin Hebraik të Jeruzalemit, Z.Yitzchak Kerem.

Në ligjëratën e tij Prof.Kerem, ndau me studentët fakte historike mbi emigrimin e hebrenjve përgjatë historisë, kontributin që ka dhënë populli shqiptar për hebrenjtë gjatë Holokaustit dhe bashkëpunimi i nevojshëm, për të parandaluar apo penguar përsëritjen e gjenocidit të karakterit të përngjashëm me situatën që po zhvillohet në Ukrainë.

